



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

URDHËR

Nr. 245, Datë 20 . 9 .2019

“PËR TARIFAT E DHËNIES SË INFORMACIONIT TË KËRKUAR”

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 1, Datë 14.01.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), i ndryshuar

URDHËROJ :

1. Dhënia e informacionit në lidhje me të drejtën për informim, të kryhet kundrejt pagesës, sipas tarifave të përcaktuara si më poshtë:
 - a. Deri në 10 fletë, informacioni përfitohet pa pagesë;
 - b. Mbi 10 fletë, pagesa të jetë 10 (dhjetë) lekë/fletë;
 - c. Për informacionin e dhënë me CD, pagesa të jetë 70 (shtatëdhjetë) lekë/CD.
2. Përlllogaritja e kostos totale të dokumentacionit të kërkuar, të kryhet nga specialisti përkatës i sektorit që përgatit informacionin e kërkuar, në bashkëpunim me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe subjekti kërkuar, të njoftohet mbi vlerën totale të pagesës.
3. Subjekti i interesuar do të marrë informacionin e kërkuar, duke paraqitur mandatin bankar, pasi të ketë kryer pagesën e tarifës përkatëse, në llogari të institucionit, sipas faturës së arkëtimit (të miratuar).
4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpunësi që përgatit informacionin e kërkuar dhe Drejtoria e Financës Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore në DSIK.
5. Ky urdhër hartohet në tre kopje të njëjta, një për Protokoll/Arkivin, një për D-4 dhe një për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
Dorian TOLA

